



Projekti Bessy (The Blood Ethical good for Social capital and SafetY) është financuar nga IPA Adriatik Program i bashkëpunimit ndërkufitar i cili i nënshtrohet bashkëpunimit institucional. Social dhe ekonomik, rrjeteve të masave sociale, të punës dhe shëndetit.

Ai ka për qëllim ngritjen e një rrjeti të qëndrueshëm politikëbërësish, organizatash joqeveritare dhe institucione të kujdesit shëndetësor në zonën e Adriatikut, të përfshirë në dhurimin e gjakut që synon dhënien e një përgjigje të përbashkët efektive problemeve të pamjaftueshmerise dhe sigurisë së gjakut të dhuruar, duke respektuar autonominë dhe identitetet e gjithësecilit dhe të promovohet dhurimi i gjakut si një e mirë etike për kapital shoqëror dhe të sigurtë.

Vendet pjesëmarrëse në zhvillimin dhe zbatimin e projektit Bessy janë Italia, Kroacia, Sllovenia dhe Shqipëria. Projekti zbatohet në nivel institucional (Ministria e Shëndetësisë, pushteti vendor) dhe nga organizata jofitimprurëse – institucione të transfuzionit të gjakut (Shoqata të Kryqit të Kuq, qendra të transfuzionit të gjakut, organizata për promocionin dhe rekrutimin e dhuruesve), me qëllim që të vendoset një politike adekuate dhe në të njëjtën kohë të mbeshten strukturat shëndetësore dhe organizatat jo fitimprurëse në arritjen e një performace të lartë në lidhje me dhurimin e gjakut.

Në çdo vend partner, projekti kërkon mbledhjen e informacionit dhe të praktikave më të mira në lidhje me çështjet e dhurimit të gjakut, veprimtarive trajnuese dhe komunikimit, analizës së metodave dhe arritjeve në veprimtaritë promocionale dhe menaxhimi i Dhuruesve Vullnetarë pa pagesë të gjakut, si edhe të “promocionit shëndetësor” në përgjithësi. Partnerët në projekt kanë zhvilluar bashkërisht një fushatë komunikimi të përbashkët të bazuar në ndarjen ndërmjet tyre të qëllimeve dhe parimeve të përcaktuara për rritjen e numrit të dhuruesve vullnetarë të gjakut në zonat e përfshira.

Përveç kësaj, projekti ka një komponentë të fortë në krijimin e kapaciteteve që konsistojnë në krijimin e një qendre njohurish dhe ekspertize virtual si dhe një network midis tyre të menaxhuar nëpërmjet kësaj faqe internet ashtu si dhe një numër veprimtarish trajnuese dhe dhënien e eksperiencës të organizuar nga partnerët në projekt në zonat e veprimtarisë së tyre.

Objektiva specifike

1. Të identifikohet një model optimal për dhurimin e mbledhjen e gjakut si në aspektin social ashtu dhe atë ekonomik, duke marrë parasysh gjithashtu ndikimin e fuqishëm që një model i tillë mund të ketë në kapitalin shoqëror.
2. Të përgatiten kritere të përbashkëta për dhuruesit që kalojnë kufijtë nëpërmjet realizimit të kartës së dhuruesit.
3. Të rritet rekrutimi dhe mbajtja e dhuruesve vullnetarë, pa pagesë të gjakut.
4. Të përgatiten fushata promovimi të përbashkëta evropiane, me synim rritjen e numrit të dhuruesve të gjakut nëpërmjet ndërgjegjësimit të dhuruesit potencialë dhe atyre aktualë

mbi çështjet e sigurisë së gjakut .

5. Të forcohet partneriteti mes organizatave joqeveritare, politikëbërësve dhe institucioneve të transfuzionit të gjakut në nivel lokal, kombëtare e rajonal.
6. Të ofrohet mundësi në ndërtimin e kapaciteteve për politikë-bërësit, institucionet e kujdesit shëndetësor dhe organizatat joqeveritare të përfshira në dhurimin dhe mbledhjen e gjakut nëpërmjet shkëmbimit të informacionit, aktiviteteve trajnuese dhe seminareve.
7. Përfitimi i një menyre të përbashkët të informimit, komunikimit, trajnimit të operatoreve dhe përdorimit të instrumentave të lidhura me to.

Paketa e punës Nr. 3

Studime përgatitore

Kjo paketë pune mbulon studime përgatitore që kanë lidhje me kontekstin në të cilin është ngritur projekt Bessy. Studimet e kryera në këtë fazë janë të nevojshme për të njohur fushat e ndryshme në të cilat do të kryhen aktivitetet e projektit.

Studimet përgatitore do të realizohen lidhur me çështjet që vijnë: përvojat më të rëndësishme dhe praktikat më të mira në lidhje me dhurimin e gjakut, kuadri i politikave, organizatat e përfshira në dhurimin e gjakut, menaxhimi i dhuruesit të gjakut dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre, kapitali shoqëror që gjeneron dhurimi i gjakut, zonat pilot. Për të analizuar aspektet e mësipërme, duke qenë se menaxhimi i dhurimit të gjakut në territoret e përfshira në projekt është i ndryshëm, është i rëndësishëm evidentimi i pikave të dobëta dhe të forta në mënyrë që të propozohen përmirësimet e mundshme.

Paketa e punës Nr 4

Modele dhe instrumente për monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit dhe të sigurisë së sistemit të dhurimit

Në paketën e punës 4 do të evidentohen dhe klasifikohen modele dhe instrumente për monitorimin dhe vlerësimin e efikasitetit dhe të sigurisë së sistemit të dhurimit. Modelet dhe instrumentet më të përshtatshme do të përzgjidhen dhe do të klasifikohen. Në mënyrë që të kryhet monitorimi dhe vlerësimi i duhur i efikasitetit dhe i sigurisë së sistemit të dhurimit, do të përcaktohen treguesit e rezultateve. Faza tjetër e kësaj pakete pune është zhvillimi i një modeli komunikimi të përbashkët për promovimin e dhurimit të gjakut në nivelin europian.

Një model i tillë do të jetë i zbatueshëm në të gjitha vendet e përfshira në projekt dhe do të lejojë një përfshirje më të madhe të dhuruesve të gjakut në të gjitha iniciativave e ndërmarra në fushën e dhurimit të gjakut. Për veç kësaj, një komunikim i menjëhershëm dhe i përshtatshëm do të kontribuojë në rritjen e numrit të dhuruesve të rinj, sidomos të rinjtë. Veprimi tjetër i kësaj pakete pune ka të bëjë me kartën e dhuruesit vullnetar pa pagesë të gjakut, brenda sistemit unik informativ. Fillimisht do të përcaktohen dhe do të klasifikohen të dhënat e nevojshme dhe pastaj



do të ngrihet dhe do të testohet modeli i kartës së dhuruesit vullnetar pa pagesë të gjakut. Të gjitha modelet e përcaktuara në këtë paketë pune do të testohen në zonat pilot të identifikuara në paketë 3 të punës.

Paketa e punës Nr. 5

Rrjeti & Qendra e njohurive dhe e ekspertizës në internet.

Partnerë të ndryshëm të angazhuar në dhurimin e gjakut si OJF, operatorë, institucione mjekësore, ekspertë që vijnë nga sektorë dhe sfera të ndryshme kombëtare, do të përfshihen në projektin Bessy. Në këtë mënyrë, do të jetë e mundur të ngrihet Rrjeti dhe Qendra e njohurive dhe e ekspertizës në nivel virtual, duke forcuar marrëdhëniet ndërmjet të gjithë aktorëve dhe aktivitetëve promovuese në zonat ndërkufitare. Ky rrjet do të mundësojë mbledhjen e informacion, veprimtaritë komunikuese dhe trajnuese (mësim në distancë gjithashtu), metodat e zakonshme të përdorura, qasjet dhe projektet e realizuara në promovimin e dhurimit të gjakut në fushën e "promocionit për shëndetin".

Për më tepër, ai do t'i japë një përgjigje efektive të përbashkët për problemet e mungesës dhe të sigurisë së gjakut. Gjatë zhvillimit të projektit, për partnerët e projektit dhe aktorë të tjerë të interesuar në tema e projektit do të ketë një pikë referimi. Pasi projekti të ketë mbaruar, Rrjeti dhe Qendra e njohurive dhe e ekspertizës do të sigurojë në vazhdimësi qëndrueshmërinë e tij, duke përfshirë anëtarë të tjerë dhe duke zgjeruar aktivitetet dhe ndikimin e tij në rritjen e numrit të partnerëve të interesuara. Në këtë paketë pune do të zhvillohet një sistem informacioni i shërbimit të thirrjes për dhurim. Një sistem i tillë do të lehtësojë disponueshmërinë e vazhdueshme të gjakut. Në fazën finale të aktivitetëve të kësaj pakete të pune, do të organizohet seminari për të mbështetur zbatimin e projektit dhe lehtësimin të rezultateve të tij.

Paketa e Punës Nr. 6

Rrjeti i kompetenca për mbështetjen e qeverive kombëtare dhe rajonale në fushën e dhurimit të gjakut

Bashkëpunimi mes organizatave të përfshira në menaxhimin e gjakut do të lejojë zbatimin e veprimeve që synojnë krijimin dhe përcaktimin e një Rrjeti të Kompetencave. Një gjë e tillë do të sigurojë rekomandime dhe mbështetje të qeverive kombëtare dhe vendore në fushën e dhurimit të gjakut. Rezultatet e Rrjeti të Kompetencës do të përmbledhen në librin e rekomandimeve që do të hartohet në bashkëpunim me ekspertët. Së fundi, do të hartohet Karta e dhuruesit vullnetar pa pagesë të gjakut. Kjo kartë do të përfaqësojë një dokument reference për çdo dhurues gjaku në të gjitha territoret e përfshira në projekt. Në mënyrë që të rrisë aksesin e saj, karta do të përkthehet në të gjitha gjuhët e të gjithë partnerëve.

